



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHD
SEKTORI PROJEKTEVE , INVESTIMEVE , SHERBIMEVE DHE STREHIMIT

Adresa : Qyteti Librazhd Nr.Tel & fax. 0514 / 2352,

e-mail: librazhdbashkia@yahoo.com.

SPECIFIKIME TEKNIKE
MBI PROJEKTIN
“SISTEMIMI PJESEVE TE DEMTUARA NE RRUGET E ASFALTUARA TE
BASHKISE LIBRAZHD”

BASHKIA LIBRAZHD

- Skarifikim shtrese Asfalti

Gerryerja e gjithë sipërfaqes së asfaltit të demtuar në një thellesi deri 2.5cm, Pastrimin e materialit të gerryer dhe përgatitjen e sipërfaqes për sferkatje me emulsion bituminoz.

- Prerje Asfalti me makineri

Ky ze përfshin teresinë e të gjithë punimeve, që lidhen me prerjen e asfaltit. Të kihet kujdes që prerja të bëhet me linjë të drejtë dhe me dimensione sipas projektit..

Në këtë cmim përfshihet cmimi i punëtorisë me shtesën për sigurimet shoqërore. Çmimi i makinerisë për prerjen e asfaltit është pranuar si ofertë 1000 leke /ora., ku përfshihet paga e specialistit dhe punëtorit, harxhimi i karburantit dhe amortizimi i makinerisë.

Në cmim përfshihet edhe struktura e koston, fitimi i planifikuar dhe ngritja e kantierit. Në strukturën e koston janë përfshirë personeli teknik (punimet topografike, matjet e ndryshme, testimet e materialeve të ndërtimit, etj) dhe personeli ndihmes.

- Germim dheu me ekskavator

Ky cmim parashikon germimin e kanalit me makineri, sipas dimensioneve të projektit. Ky cmim parashikon gjithashtu ngarkimin e dheut në automjete , transporin e tij në një distancë 1km nga vendi i germimit, shkarkimin dhe sistemimin e tij. Në cmim përfshihet paga e specialistit dhe punëtorit dhe shtesa për sigurimet shoqërore, harxhimi i karburantit dhe amortizimi i makinerisë. Në cmim përfshihet gjithashtu struktura e koston, fitimi i planifikuar dhe ngritja e kantierit. Në strukturën e koston janë përfshirë personeli teknik (punimet topografike, matjet e ndryshme, testimet e materialeve të ndërtimit, etj) dhe personeli ndihmes.

- **Shtrese çakelli**

Ky ze perfshin teresine e te gjithë punimeve, qe lidhen me mbushjen me cakell. Te kihet kujdes ne ngjeshjen e cakellit, deri ne densitet 98%. Cakelli duhet te jete nga thyerje e gurit te kaves me granulometri jo me shume se 5/40.

Te behen provat e materialit per plotesimin e kushteve teknike per materialin qe perdoret. Indeksi i plasticitetit te cakellit nuk duhet te kaloje 10-ten, nuk duhet te permbaje grimca me permasa mbi 2/3 e trashesise se shtreses ne sasi mbi 5% dhe nuk duhet te permbaje mbi 10% grimca te dobeta dhe argjilore. CBR minimale duhet te jete 30%.

Ne kete cmim perfshihet cmimi i punetorese me shtesen per sigurimet shoqerore.

Gjithashtu eshte parshikuar ne cmim edhe transporti i cakellit deri ne objekt.

Ne cmim perfshihet edhe struktura e kosos, fitimi i planifikuar dhe ngritja e kantierit. Ne strukturen e kosos jane perfshire personeli teknik (punimet topografike, matjet e ndryshme, testimet e materialeve te ndertimit, etj) dhe personeli ndihmes.

- **Shtrese stabilizant**

Ky ze perfshin te gjitha proceset dhe materialet qe duhen per ndertimin e shtreses uniforme me trashesi 10cm te stabilizantit, pas shtreses paraardhese te themelit te rruges. Ne çmim perfshihet kosto e blerjes se materialit, furnizimit, transportit, depozitimi, shtrimi dhe nivelimi me grejder dhe cilindrim me 5-6 kalime vajtje ardhje deri ne ngjeshje 98 %. Stabilizanti duhet te jete nga thyerja e gurit te kavos, me granulometri 5/35. Kjo shtrese nuk duhet te permbaje material copezues (prishes) si psh. pjese shkembinjsh te dekompozuar ose material argjilor Agregati i thyer duhet te plotesoje kerkesat e meposhteme:

1.- Vlera e themimit te tij ne testin Los Anxhelos te jete $LA < OSE = 30\%$

2.- Indeksi i plasticitetit (PI) nuk duhet te kaloje 6

- **Shtrese Bideri**

Ne kete ze perfshihet shperndarja e biderit ne menyre uniforme, me trashesi 5cm., cilindrimin e tij, pas perfundimit te shtreses uniforme te ngjeshur dhe te profiluar mire te stabilizantit. Te behet pastrimin nga papastertite e mundshme, para shperndarjes se biderit, duhet te behet sperkatja e siperfaqes me prajmer 0.5 litra/m². Sperkatja me bitum, duhet te behet ne perputhje me specifikimet P-1 “Sperkatja me bitum i asfaltit te shtreses baze kokrrizor”. Sasia e biderit, duhet te jete e tille, qe te siguroje pas rulimit, trashesine minimale te percaktuar ne projekt (5 cm). Shtrimi duhet te behet ne temperaturen dhe konsistencen e duhur. Pas shperndarjes, bideri duhet te rulohet. Ana e shtreses se biderit, duhet te realizohet me ane te drejtuesve per te ruajtur linearitetin e tyre, si dhe rezet e kurbaturave ne kthesa. Shtresa e biderit, duhet te plotesoje keto kerkesa teknike, sipas STASH 660-87

1. - Rezistenca ne shtypje ne temperaturen 50°C/ cm², jo me pak se 6.

2. - Poroziteti perfundimtar, pas ngjeshjes ne %, ne vellim 7-10.

3. - Ujethithja % ne vellim jo me shume se 7-10.

4. - Mufatja % ne vellim jo me shume se 2.

5. Rruga te shtrohet me krahe, me gjeresine e kërkuar.

- **Sperkatje me emulsio bituminoz**

Sperkatia me emulsion bituminoz do te behet e gjithë sipërfaqja që është përgatitur për asfaltim pak orë para se të fillojë asfaltimi në mënyrë që asfaltobetonit që do të hidhet të ngjitet me trupin e rruges.

- **Shtrese Asfaltobeton**

Në këtë zë përfshihet shpërndarja dhe rullimi i shtresës prej 4 cm të asfaltobetonit.

Paraprakisht, duhet të bëhet pastrimi i sipërfaqes nga të gjitha mbeturinat. Për shpërndarjen duhet të bëhet sperkatja e sipërfaqes me përafërsisht 0.5l/ m². Sperkatja me bitum duhet të bëhet në përputhje me specifikimet P-1 “Sperkatja me bitum i asfaltit të shtresës baze kokrrizor”. Sasia e asfaltobetonit duhet të jetë e tillë që të sigurojë, pas rullimit, trashësinë uniforme minimale të përcaktuar në projekt (4cm).

Bitumi që do të përdoret për asfaltim, duhet të plotësojë kërkesat e STASH 660-87, ndërsa çakelli, zalli, zalli i thyer dhe granili, duhet të plotësojë kërkesat e STASH 539-87 “Për punime ndërtimi”. Zalli i thyer duhet të përmbajë, jo më pak se 35 % kokrrizate të thyera, me madhësi 5 mm. Sasia e kokërrizave të dobta (me rezistencë me pak se 800 kg/ cm²) nuk duhet të jetë më shumë se 10 % në peshë. Rera për prodhimin e asfaltobetonit, duhet të plotësojë kërkesat e STASH 506-87 “Rera për punime në ndërtim”. Pluhuri mineral, duhet të ketë imtësinë të tillë që të kalojë 100 % në siten me madhësi të vrimave 1.25 mm dhe të kalojë jo më pak se 70 % në peshë në siten 0.074. Koeficienti i hidrofilitetit, i cili shpreh dhe aftësinë lidhëse me bitum jo më shumë se 11. Trashësia e shtresës së asfaltobetonit në momentin e shtrimit në rrugë, duhet të jetë 1.2 – 1.25 % më shumë nga shtresa e dhënë në projekt zbatim, në gjendje të ngjeshur.

Temperatura e masës së asfaltobetonit në momentin e shtrimit në rrugë, duhet të jetë në kufijtë 130-150 grade. Ngjeshja e shtresës së asfaltobetonit për gjysmën e parë të rrugës, të fillojë nga buzina (bankina)

Bitumi që përdoret për asfaltim, duhet të plotësojë kërkesat e STASH 660-87, ndërsa çakelli, zalli, zalli i thyer dhe granili, duhet të plotësojë kërkesat e STASH 539-87 “Për punime ndërtimi”. Zalli i thyer duhet të përmbajë, jo më pak se 35 % kokrrizate të thyera, me madhësi 5 mm. Sasia e kokërrizave të dobta (me rezistencë me pak se 800 kg/ cm²) nuk duhet të jetë më shumë se 10 % në peshë. Rera për prodhimin e asfaltobetonit, duhet të plotësojë kërkesat e STASH 506-87 “Rera për punime në ndërtim”. Pluhuri mineral, duhet të ketë imtësinë të tillë që të kalojë 100 % në siten me madhësi të vrimave 1.25 mm dhe të kalojë jo më pak se 70 % në peshë në siten 0.074. Koeficienti i hidrofilitetit, i cili shpreh dhe aftësinë lidhëse me bitum jo më shumë se 11. Trashësia e shtresës së asfaltobetonit në momentin e shtrimit në rrugë, duhet të jetë 1.2 – 1.25 % më shumë nga shtresa e dhënë në projekt zbatim, në gjendje të ngjeshur.

Temperatura e masës së asfaltobetonit në momentin e shtrimit në rrugë duhet të jetë në kufijtë 130-150 grade.

Pas shpërndarjes, binderi duhet të rullohet. Ana e shtresës së asfaltobetonit, duhet të realizohet me anë të drejtuesve për të ruajtur linearitetin e tyre, si dhe rezet e kurbaturave në kthesa. Shtresa e asfaltobetonit, duhet të plotësojë këto kërkesa teknike, sipas STASH 660-87

1.- Rezistenca në shtypje në temperaturën 50°C/ cm², jo më pak se 6.

2.- Poroziteti i perfundimtar, pas ngjeshjes në %, në vëllim 7-10.

3.- Ujëthithja % në vëllim jo më shumë se 7-10.

4.- Mufatja % ne vellim jo me shume se 2.

Rruga te shtrohet me krahe, me gjeresine e kerkuar

Marrja e kampioneve te behet cdo 2500 m², duke plotesuar te gjithë treguesit sipas kushteve teknike .

- Trotuar objekti me pllaka granili

Përmbi bazën do të vendohet një shtresë rere trashësi maksimale prej 2 cm mbi të cilën do të vendosen pllakat e granili. Shtresa e reres duhet te jete 2/5 mm deri 0/4 mm. Ajo do të rrafshohet dhe mbi atë duhet të vendosen pllakat e granilit. Më në fund fugat e pllakave do të mbushen me rere te imet në atë mënyrë që pllakat të lidhen më së miri njëra me tjetren dhe të përforcohet/stabilizohet shtresa e pllakave të granilit. Investitori /Supervizori së bashku me sipermarresin duhet të bien në marrëveshje ndaj modelit, dimensioneve dhe ngjyrës së pllakave

- Puseta

Ky cmim perfshin koston per realizimin e ndertimit te nje pusete tip sipas dimensioneve te dhena ne projekt. Ne cmim perfshihet blerja e materialit , ngarkimi, transporti deri ne kantier, puntoria per pergatitjen dhe vendosjenn e elementeve.Çmimi i referohet ndertimit te pusetes komplet duke perfshire te gjitha proceset e punes si germimi, shtresen e zhavorit,shtresen e betonit, betonimin e mureve vendosjen e elementeve parafabrikar dhe monolitizimin e kapakeve b/a. Ne cmim perfshihet gjithashtu srtuktura e koston, fitimi i planifikuar dhe ngritja e kantierit. Ne strukturen e koston jane perfshire personeli teknik(punimet topografike, matjet e ndryshme, testimet e materialeve te ndertimit, etj) dhe personeli ndihmes.

Per te gjithë zerart e punimeve, te zbatohen me rigorozitet kushtet teknike te zbatimit te punimeve, duke perdorur materiale qe plotesojne standartet ne fuqi. Theksojme , qe per te gjitha proceset e punes, duhet te zbatohen me rigorozitet kushtet teknike te zbatimit te punimeve te ndertimit gjate ndertimit te objektit dhe te perdoren materiale ndertimi sipas standarteve ne fuqi.

Duke pasur parasysh kerkesat e detyres se projektimit per ndertimin e rrjetit te kanalizimeve jane marre parasysh:

1. Rrjeti I kanalizimeve eshte dimensionuar I tille per prespektive 25vjecare
2. Pika e shkarkimit do te jete zone do te jete koletori i ujrave te bardha dhe te zeza

- Gabion me rriete teli

Perfshin teresine e punes qe nevojitet per vendosjen e gabionave ,blerjen e materialeve gure kave, rrjete gabian zingat, tel zingato,e te materialeve te ndryshme qe nevojiten per vendosjen e tyre,transportin, shkarkimin, vendosjen ne veper, dhe çdo gje tjeter qe lidhet me realizimin e ketij zeri sipas projektit. Çmimet i referohen 1 m³ gabiona.

Per realizimin e pritave gabion do te perdoren rrjete teli gabion i xinguar. Rrjeta e telit do te merret ne perputhje me permasat e ndryshme te dhena ne projekt. Rrjetat e telit duhet te jene te sistemit heksagonal me permasa 10 x 8 cm .

Guri qe do te perdoret per mbushje duhet te jete gur kave me peshe specifike te larte . Vendosja e gureve nga faqja e ekspozuar e murit duhet te behet ne menyre te rregullt. Perpara fillimit tabani duhet te nivelohet mire. Elementet duhet te bashkohen ne menyre te sigurte per gjate gjithë gjatesise se buzeve te kontaktit me ane te telit lidhes. Sistemi i lidhjes se koshave te jete monotek ku tavani koshit te poshtem sherben si dysHEME per koshin e siperm. Perpara se te behet mbushja me gure koshat duhet te terhiqen derisa te marrin formen e duhur. Guret per mbushje ne vendet e dukshme do te zgjidhen me kujdes me madhesi te njejte dhe te vendosen me dore. Bashkimet vertikale te koshave duhet te behen te shkallezuara sipas skices se dhene.

PUNOI
ZYRA PROJEKTEVE, INVESTIMEVE

LIBRAZHD, SHKURT 2019

